



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ROMANO-PORT.Sh.a
DURRES-ALBANIA

**RREGULLORE E FUNKSIONIMIT
TE PORTIT TE PERPUNIMIT
TE LENDEVE DJEGESE
PER SHOQERINE
ROMANO - PORT**

MIRATUAR ME VENDIMIN E ORGANIT SHTETEROR TE AUTORIZUAR
NR. 4, DATE 27 04: 2009

Prill 2009

RREGULLORJA
NR. 4, DATE 27 / 04 / 2009

PER FUNKSIONIMIN E PORTIT TE PËRPUNIMIT TE LENDEVE
DJEGESE PER SHOQERINE "ROMANO PORT" SH.A.

Mbështetur në nenin 5, të marrëveshjes së koncesionit të ratifikuar me ligjin nr.9298, datë 28.10.2004 "Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit, të formës BOT (ndërtim, shfrytëzim, transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës", ndryshuar me ligjin nr. 9578, datë 11.7.2006 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në marrëveshjen e koncesionit, të formës BOT, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës, ratifikuar me ligjin nr. 9298, datë 28.10.2004" dhe

Mbështetur në vendimin nr. _____, datë ____ . ____ . 2009, të Organit Shtetëror të Autorizuar (O.SH.A.), të përberë nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës; Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit; Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

PERMBAJTJA E RREGULLORES

KREU I

Qëllimi , Fusha e Zbatimit , Termat

1. Qëllimi,
2. Fusha e zbatimit,
3. Termat

KREU II

Procedura per Komunikimin para Mberitjes se Anijes ne Port

- Neni 1.** Njoftimet për Mbërritjen e Anijes

KREU III

Qendrimi ne Raden e Portit dhe Hyrja / Dalja e Anijeve nga, e per ne Port

- Neni 2.** Hyrje
- Neni 3.** Sherbimi i Rimorkimit të Anijes, Dhënia Ndhimes si dhe Shërbime per Transportin e Njerezve ose Furnizimeve për Anijet
- Neni 4.** Ankorimi dhe Qendrimi ne Kalate

KREU IV

Veprimet e Hyrjes, Shkarkimit dhe Daljes se Anijes nga Porti

- Neni 5.** Standartet Teknike per Akostimin e Anijeve ne Platforme
- Neni 6.** Kushtet Teknike dhe Meteorologjike per Hyrjen ne Platorme
- Neni 7.** Qendrimi i Anijes ne Platforme
- Neni 8.** Lidhjet Elektrike te Anijes dhe te Tubacioneve te Pjeses Tokesore
- Neni 9.** Testet dhe Verifikimi i Manikotave Fleksibel
- Neni 10.** Operacionet e Ngarkimit dhe Shkarkimit
- Neni 11.** Transferimi i Ngarkeses nga Anija ne Anije

KREU V

Veprimet Per Marrjen e Kampionit

- Neni 12.** Sondazhet dhe Marrja e Mostrave te Ngarkeses
- Neni 13.** Rregjistruesit Automatike te Mostres, te Presionit, te Temperatures, te Prurjes te jene Instaluar ne Krahet e Shkarkimit, Tubacionet, etj
- Neni 14.** Kompanite dhe Personeli i Ngarkuar per Sondazhet dhe Marrjen e Mostrave te Ngarkeses

KREU VI

Sherbime te Ndryshme

- Neni 15.** Operacionet qe Perfshijne Rrjedhjen e Produkteve te Naftes ne Tubacione
- Neni 16.** Rregullat per Ruajtjen e Ambientit Detar nga Ndotja

- Neni 17.** Ballastimi (Ekuilibrim me Ballastra)
- Neni 18.** Marrja ose Heqja e Furnizimeve dhe Pajisjeve te Anijes
- Neni 19.** Operacionet e Furnizimit te Anijes me Lende Djegese, Ushqime, Uje, etj.
- Neni 20.** Anijet dhe Barkat qe Ankorohen prane Anijes-Cisterne
- Neni 21.** Impiantet e Gazit Inert
- Neni 22.** Avarite e Sistemit te Gazit Inert
- Neni 23.** Funkcionimi i Laboratorit te Portit te Lendeve Djegese
- Neni 24.** Ndalimi i Duhanit, Ndezja e Zjarrit dhe Perdorimi i Aparateve qe Prodhojne Shkendija
- Neni 25.** Ndalohet te Perdoren Materiale te Rrezikshme
- Neni 26.** Punimet qe kane te Bejne me Flake te Pambrojtura dhe me Pajisje qe Mund te Prodhojne Shkendija
- Neni 27.** Sherbimi i Mbrojtjes Kunder Zjarrit ne Portin e Hidrokarbureve "Romano Port" Sh.A.
- Neni 28.** Stervitja per Shuarjen e Zjarrit
- Neni 29.** Detyrimi per te Raportuar cdo te Papritur qe Mund te Prishe Sigurine
- Neni 30.** Gjendja e Emergjences
- Neni 31.** Hyrja e Personave ne Zonat e Kufizuara (Ndaluara)
- Neni 32.** Masat e Sigurise ne Raste te Motit dhe te Kushteve te Detit te Pafavorshem
- Neni 33.** Operacionet qe Duhet te Permbushen Perpara Mberritjes se Anijes
- Neni 34.** Autorizimi per Zbatimin e C.O.W.
- Neni 35.** Pezullimet dhe Ndalesat per Funkcionimin e C.O.W.

KREU VII

Bashkrendimi me Organet Shteterore

- Neni 36.** Detyrimet e Subjekteve Pritese dhe Nisese te Ngarkesave dhe Komunikimi me Autoritetet e Portit
- Neni 37.** Bashkrendimi i Veprimeve me Autoritetet Doganore
- Neni 38.** Bashkrendimi me Organet e Policise Kufitare

SHTOJCA

- | | |
|-----------|------------|
| Shtojca 1 | Shtojca 2 |
| Shtojca 3 | Shtojca 4 |
| Shtojca 5 | Shtojca 6 |
| Shtojca 7 | Shtojca 8 |
| Shtojca 9 | Shtojca 10 |

KREU I

QËLLIMI , FUSHA E ZBATIMIT , TERMAT

1- Qëllimi,

Qëllimi i kësaj rregulloreje është organizimi i të gjithë veprimtarisë juridike administrative, tregtare për funksionimin e portit të "Porto Romano" si port i për trafikun ndërkombëtar detar dhe plotësimi i të gjithë standardeve të përcaktuara në Konventat Ndërkombëtare Detare për të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Fusha e zbatimit,

Dispozitat e kësaj Rregullore:

Zbatohen në Portin e Hidrokarbureve të "Romano-Port" Sh.a., ndaj të gjitha anijeve që transportojnë naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre (që konsiderohen ngarkesa të rrezikshme), operatoreve dhe personave fizike e juridik që marrin pjesë në përpunimin, depozitimin, transportimin e ngarkesave të rrezikshme dhe materialeve të dëmshme të parashikuara në Kodin Ndërkombëtar të Ngarkesave Detare të Rrezikshme - IMDG CODE, Kodit Detar Shqiptar dhe ligjit Nr.9130, Dt. 08.09.2003-Për Autoritetin Detar. Si dhe Konventave SOLAS 1974 e amenduar me Kapitullin XI/2, , MARPOL e amenduar,

Administrata e Portit të Hidrokarbureve të Porto Romanos është përgjegjës për plotësimin e kushteve dhe standardeve të nevojshme për funksionimin e këtij porti si port i hapur për trafikun ndërkombëtar detar.

Në Portin e Hidrokarbureve të Porto Romanos ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe Organet Shtetërore të përcaktuara mbi bazën e legjislacionit të Republikës së Shqipërisë (Kapiteneria e Portit, Drejtoria e Kufirit, Drejtoria e Doganave, Qendra Shëndetësore dhe organe të tjera që kanë lidhje me funksionimin normal të këtij porti)

3 – Termat

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë kuptimin:

ISPS	Kodi Ndërkombëtar i Sigurisë në Anije dhe Porte.
IMO	Organizata Ndërkombëtare Detare.
SOLAS 1974 e amenduar	Konventa Ndërkombëtare e Sigurisë së Jetës në Det.
IMDG	Kodi Ndërkombëtar Detar për Mallra të Rrezikshme.
COW	Metoda e Larjes së Cisternës me Naftë Bruto.

MARPOL 73/78	Konventa Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes së Mjedisit Detar 73/78
IOPP	Certifikata Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Hidrokarburet.
OSHA	Organi Shtetëror i Autorizuar
DWT	Pesha e plotë e anijes ku përfshihet pesha neto e anijes, furnizimet me karburant dhe ujë si dhe ngarkesa e saj.
Deklarate Sigurimi	Marrëveshje ndërmjet anijes dhe portit, e cila përcakton masat e sigurimit që do të zbatohen nga secila pale.
Port	Tërësia e hapësirës ujore detare, si dhe strukturës e infrastrukturës portuale, e përcaktuar për kryerjen e veprimtarive të anijeve detare, me karakter tregtar, prodhues, riparues, detar ose për qëllime të tjera detare.
Terminal Portual	Vendi i përcaktuar ku realizohet akostimi i anijes me qëllim kryerjen e përpunimit të saj.
Administrata e Portit	Organi drejtues i portit, sikurse përcaktohet në ligjin nr. date "Për autoritetin Portual".
Drejtuesi i Portit	Drejtori i Portit sipas rastit përfaqësues të tjerë administrativ të tij.
Personat e Autorizuar	Punonjës të Forcës së Sigurisë së Fasilitetit Portual.
Zone Portuale	Tërësia e zonave tokësore dhe detare, të përcaktuara që shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë së portit, (tërësia e elementeve të infrastrukturës së portit për realizimin e shërbimeve dhe të veprimtarisë portuale).
Fasilitetit Portual	Struktura portuale.
Kalatë	Vend akostimit të anijeve.
Zone e kufizuar	Zona e përcaktuar si zonë me rrezikshmëri të lartë për sigurinë e portit .
GLN	Gaz i Lënget i Naftës.
Ekstremisht të ndezshme	Janë lëndet që, në gjendje të lënget, kanë pike flakërimi me të ulet se 0°C dhe pike vlimi me të ulet se 35 °C ose që janë të ndezshme në gjendje të gazte në kontakt me ajrin në temperaturë (të dhomës) dhe presion (atmosferik) normal.
Balaste	Ujëra të vendosura në anije për rritjen e qëndrueshmërisë së anijes, ujërat e ndotura me vajra.
Slope	Mbeturina me origjinë vajore
t	Ton (njësi matje, peshe).
Hidrokarbur	Nafta Bruto ose Gazi natyror.
Force madhore	Ngjarje ose një akt natyror apo shoqëror i jashtëzakonshëm
Akostim / ankorim	Pozicionimi i anijes në kalatë dhe në radë për zhvillimin e operacioneve të ngarkim/shkarkimit si dhe proceseve të tjera që paraqet nevoja e anijeve.

Radë	Zona ujore detare, jashtë akvariumit te portit, ku anija qëndron ne pritje për ankorim.
Plan Emergjence	Plani i përgatitur dhe miratuar për përballimin e emergjencave dhe qe shpreh masat për parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin e zonës se prekur.
VHF	Sistemi komunikimi me radio.
Anije	Termi anije nënkupton çdo mjet detarë i tipave të ndryshme dhe që kryen një veprimtari detare të çdo lloji. (këtu përfshihen dhe hidroplanët, nëndetëse, mjetet lundruese dhe platformat fikse ose lundruese.
Monobova	Platforme pluskuese teke qe ndodhet ne det dhe sherbejne për akostimin e sigurte të anijes dhe përpunimin e saj.
Bunkerim	nënkupton operacionet e marrjes dhe dhënies me karburant për anijet.

KREU II

PROCEDURA PER KOMUNIKIMIN PARA MBERRITJES SE ANIJES NE PORT

NENI 1. NJOFTIMET PËR MBËRRITJEN E ANIJES

Axhenti i anijes njofton tek Administrata e Portit dhe ne Kapitenerinë e Portit 72 - ore para mberritjes se anijes ne rade, duke dhene informacionin paraprak mbi karakteristikat, tipin dhe sasine e ngarkese qe do te shkarkohet.

Axhenti duhet të përfshijë në informacion jo me pak se 24 ore para mberritjes se anijes ne rade:

- Emrin e anijes
- gjatesine, gjeresine dhe zhytjen e anijes;
- flamurin e anijes;
- numrin dhe madhesine e depozitave;
- police-ngarkesën (numrat dhe shenjat);
- sasinë (peshën) qe do te shkarkohet;
- numrin e depozitave;
- përshkrimin e paketimit (ambalazhit);
- shpërndarjen e ngarkesës sipas depozitave;
- përshkrimin e përmbajtjes duke menduar ne mënyrë specifike mallrat e rrezikshme;
- pritësin e mallit;

KREU III

QENDRIMI NE RADEN E PORTIT DHE HYRJA / DALJA E ANIJEVE NGA, E PER NE PORT

NENI 2. HYRJE

1. Të gjitha anijet që mbërrijnë për tu përpunuar ne port për çdo rast qëndrojnë në Radën e Portit të Hidrokarbureve të Porto Romanos, përcaktuar me koordinatat si më poshtë:

Φ 41° 15' 000" V

λ 19° 22' 007" L

2. Anijet që mbërrijnë ne Radën e portit komunikojnë me Kapitenerinë e Portit ne kanalën e përcaktuar nga ajo, për tu informuar për të gjitha rregullat që duhet të zbatohen ne Port, për kohën kur do të merret praktika e lire. Hyrja dhe Dalja e anijeve nga e për ne port kryhet vetëm mbas marrjes së praktikës së lire.

3. Pilotimi i gjithë anijeve që do të përpunohen ne këtë port është i detyrueshëm. Ai kryhet nga pilot i licencuar nga Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit, për Kategorinë A. Gjatë pilotimit, piloti zbaton Rregulloren e Pilotimit të Republikës së Shqipërisë si dhe rregullat e komunikimit me anijen dhe Kapitenerinë. Ne këtë Port **NUK LEJOHET** të dalin anije pa pilot. Ankorimi dhe cakostimi për largimin e anijeve cisterne ne Port, vendoset nga Kapiteneria dhe sipas normave të parashikuara për portet e hidrokarbureve.

4. Përpara Ankorimit, gjatë qëndrimit në pritje në radë të anijes cisterne, që transporton hidrokarbure, duhet të marrë certifikatën që është ne përshtatje sipas Kodit I.S.P.S.. Kjo certifikatë e përpunimit të anijes lëshohet nga Drejtoria e portit në bashkëpunim me Kapitenerinë e portit dhe Drejtuesin e Forcave të Sigurisë së këtij Porti. Pas kësaj fillon operacioni për akostimin dhe cakostimin e anijes.

5. Përpara largimit nga porti dhe nga ujerat rreth tij të gjitha anijet duhet të sigurohen që nuk ka manovrimë anijesh ne port. Pilotet e Portit do të kontaktojnë me Portin për tu siguruar që nuk ka anije të tjera ne lëvizje.

NENI 3. SHERBIMI I RIMORIKIMIT TË ANIJES, DHËNIA NDIHMES SI DHE SHËRBIME PER TRANSPORTIN E NJEREZVE OSE FURNIZIMEVE PËR ANIJET

Rimorkimi i anijeve që do të përpunohen ne këtë port është i detyrueshëm. Rimorkimi kryhet mbështetur ne legjislacionin ne fuqi për portet e Republikës së Shqipërisë.

Rimorkiatori ne pronësi mund të përdoret vetëm për operacione shpëtimi ose për fikjen e zjarrit.

NENI 4. ANKORIMI DHE QENDRIMI NE KALATE

1. Anijet e akostuara ne kalatë duhet te përdorin vetëm cima. **NDALOHET** përdorimi i kavove metalike.
2. Nuk lejohet te hidhet spiranca ne zonën e Platformës ne një distance 30 m larg saj.
3. Anijet e akostuara ne Kalatë duhet te jene gjithmonë ne gatishmëri dhe me ekuipazh te mjaftueshëm për te kryer manovra, ne raste emergjence ose kur urdhërohet nga Kapiteneria për te lëshuar kalaten.
4. Duhet te mbahen ne gjendje gadishmërie dhe ndërhyrje te gjithë mjetet e shuarjes se zjarrit ne bord si dhe personeli i nevojshëm për te manovruar.
5. Në rast emergjence në rast se është e nevojshme do të jenë në dispozicion dy cima te fuqishme prej çeliku me gjatësi 200 m te përshtatshme për rimorkim ne kicin dhe \ne bashin e anijes .
6. Gjatë gjithë kohës së qëndrimit në kalatë duhet të sigurohet ndriçim i mjaftueshëm i anijes në kuverte, në kalatë dhe tek manifulti.
7. Mjetet e ngjitjes ne bord (shkallet, shkallet e lëvizshme) duhet te jene te fiksuara mire ne bord dhe me largësi te mjaftueshme, te pastra, ne kushte te mira dhe sipas normave.
8. Gjate qëndrimit ne port, anija duhet te këtë një shërbim te mjaftueshëm. Një anëtar i ekuipazhit duhet te gjendet gjithmonë i pranishëm ne shkallen e saj.
9. Gjate qëndrimit ne port, radiot transmetuese duhet te jene te tokëzuara, dhe aparati duhet fikur. Duhet ndjekur kanali 10 ne VHF vazhdimisht për përgjigje te menjëhershme. Njëkohësisht nuk lejohet përdorimi i aparateve celular.
10. Gjatë gjithë kohës së qëndrimit te anijes ne port **NDALOHET** përdorimi i radarëve dhe saldimeve te ndryshme ne bordin e saj.

KREU IV

VEPRIMET E HYRJES, SHKARKIMIT DHE DALJES SE ANIJES NGA PORTI

NENI 5. STANDARTET TEKNIKE PER AKOSTIMIN E ANIJEVE NE PLATFORME

1. Ne platforme akostohen anije me te dhënat e mëposhtme:

• Anije me DWT 1.000 ton	zhytja 3.5m
• Anije me DWT 2.000 ton	zhytja 4.5m
• Anije me DWT 3.000 ton	zhytja 5.5m
• Anije me DWT 5.000 ton	zhytja 6.0m
• Anije me DWT 8.000 ton	zhytja 7,0m
• Anije me DWT 10.000 ton	zhytja 7.2m
• Anije me DWT 12.000 ton	zhytja 8.7m
• Anije me DWT 15.000 ton	zhytja 9,2m
• Anije me DWT 20.000 ton	zhytja 9.5m
• Anije me DWT 35.000 ton	zhytja 10,36m
• Anije me DWT 40.000 ton	zhytja 11.5m

2. Për te gjitha anijet me çfarëdo DWT - je qe kryejnë manovra për akostimin ne platforme, rruga e hyrjes duhet te jete e lire.

NENI 6. KUSHTET TEKNIKE DHE METEOROLOGJIKE PER HYRJEN NE PLATORME

1. Gjatë akostimit dhe qëndrimit në kalatë në Portin e Hidrokarbureve ne Porto Romano duhet të plotësohen kushtet meteorologjike si më poshtë :

për anijet cisterne deri 20.000 DWT

- Lartësi dallge 1.0m;
- Shpejtësi ere 15 m/s;
- Shpejtësi rryme 0,5 m/s;

për anijet cisterne deri 30.000 DWT

- Lartësi dallge 1.5m;
- Shpejtësi ere 15 m/s;
- Shpejtësi rryme 0,5 m/s;

Kushtet meteorologjike mbahen ne vrojtim nga Kapiteneria e Portit dhe Kapiteni i anijes.

Përpara se te lejohet afrimi i anijes çisterne ne platformën e Portit, duhet te verifikohet nëpërmjet sistemit te monitorimit te instaluar ne platforme, nëse kushtet e motit dhe te detit si : lartësia e valës, perioda e dallgës dhe shpejtësia e erës përfshihen ne limitet e dhëna me lart.

Përcaktimi i kryerjes se manovrave për akostim ne platforme vendoset nga Kapiteneria e Portit, e cila merr masat e nevojshme për sigurinë e manovrave duke komunikuar me anijen.

NENI 7. QENDRIMI I ANIJES NE PLATFORME

Gjate qëndrimit ne platforme është e detyrueshme mbajtja ne gadishmëri e një rimorkiatori për te siguruar anijen nga përplasjet me platformën dhe për çdo rast emergjence.

Njëkohësisht mbahet kontakt me Kapitenerinë e Portit për çdo informacion që ka të bëjë me kushtet meteorologjike.

NENI 8. LIDHJET ELEKTRIKE TE ANIJES DHE TE TUBACIONEVE TE PJESES TOKESORE

Ne qofte se lidhjet ne mes te tubacioneve te bordit dhe te tokës, janë realizuar me tuba me lidhje metalike te brendshme ne fund te fllanxhave ato mund te kryhen vetëm pasi anija është lidhur me kavo me impiantet e fiksuara ne toke.

Kavoja qe bën lidhjen me token do te s'takohet, te gjithë operationet te kene përfunduar dhe tubat te jene hequr.

Ne te kundërt nuk do te kryhet asnjë lidhje e skafit, nëse krahët e shkarkimit po përdoren, ose ne qofte se po përdoret një tub i izoluar (pa një lidhje metalike midis fundit te fllanxhave).

NENI 9. TESTET DHE VERIFIKIMI I MANIKOTAVE FLEKSIBEL

Te gjithë manikotat e përdorura për ngarkimin dhe shkarkimin e produkteve me përmbajtje kimike do te testohen dhe kontrollohen perpara dhe gjate perdorimit te tyre. Me kete synim, nje format do te mbushet per cdo tub me te dhenat si me poshte:

- identifikimi i numrave te tubave;
- testet e certifikuara te leshuara nga prodhuesit para perdorimit ;
- data e perdorimit te pare;
- kontrolli vjetor i (presionit, zgjatjes, vazhdimit te brendshem, etj.;

Tubat fleksibel te instaluar ne mono-bova ose ne strukturen e platformes do t'u nenshtrohen kontrolleve dhe testeve te parashikura dhe te certifikuara sipas rregullores;

NENI 10. OPERACIONET E NGARKIMIT DHE SHKARKIMIT

1. Gjate qendrimit te anijes ne Terminal, Administrata e Portit merr masat për realizimin e sigurtë të përpunimit të anijes, njëkohësisht kapiteni i anijes, mban kontakt të vazhdueshëm me Kapitenerinë e Portit, për çfarëdo lloj rrethane qe krijohet, e cila vë në rrezik anijen dhe strukturat e portit para ose mbas kryerjes se përpunimit.

2. Anijet me ngarkese produkt hidrokarbure me pike flakerimi me te ulet se 60°C, gjate qendrimit ne port, duhet detyrimisht te jene te pajisura me sistemin e gazit inert, dhe te kene ne bord (rojtar zjarri). Ne rastet e anijeve-cisterne qe transportojne produkte petrolifere me pike flakerime me te larte se 60°C, gjate qendrimit ne port, edhe sikur te jene te pajisura me sistemin e gazit inert, mbikqyrja e nje punonjesi shtese per shuarjen e zjarreve (zjarrefikes), nuk do te jete e nevojshme, me kusht qe Kapiteni i anijes do te urdheroje vezhgim te plote te drejtuar nga personel i trajnuar e te specializuar, ne permbushje me rregullat e Autoriteteve Detare.

3. Perpara fillimit te operacioneve te shkarkimit mes anijes dhe terminalit, duhet te kete shkembim informacionesh, ku te transmetohen te gjitha informacionet e mundshme drejt terminalit (Shtojca 5). Gjithashtu Kapiteni i dorezon perfaqesuesit te portit perpara fillimit te përpunimit te anijes, dokumentacionin si me poshte:

- Plani i shkarkimit;
- Dokumentat e Mallit (kopje të Polic ngarkesave per çdo lloj malli
- Dokumentin e Larjes me Nafte bruto;
- Planin e Ballasteve;
- Planifikimi i sistemit te komunikimit ndermjet anijes/zone e kufizuar/terminal; (shtojca 6)

NENI 11. TRANSFERIMI I NGARKESES NGA ANIJA NE ANIJE

Anija cisterne e ankoruar ne Platformen e Portit, nuk mund te kryeje transferimin direkt te ngarkeses me nje anije tjeter.

Ky operacion mund te kryhet, brenda Portit duke perdorur pajisjet e Portit te Hidrokarbureve "Romano Port" sh.a., ose duke qene ne Rade, konforme rregullave te percaktuara per kete qellim.

KREU V

VEPRIMET PER MARRJEN E KAMPIONIT

NENI 12. SONDAZHET DHE MARRJA E MOSTRAVE TE NGARKESSES

- a) Sondazhet dhe marrja e mostrave te ngarkeses ne anije te pajisura me Sistemin e Gazit Inert, duhet te kryhen nepermjet sistemit te sondazhit. Anijet me tonazh mbi 10.000t ngarkese produktesh, ku pika e flakerimes eshte jo me shume se 60° C, te cilat nuk jane pajisur me mjetet e permendura me siper, duhet te kryejne marrjen e kampionit (mostres) te produktit (ngarkeses) ne momentin qe anija ndodhet ne Rade, para hyrjes ose pas daljes nga Porti.
- b) Nga sa parashikohet ne piken a) mund te shqyrtohen nga Kapiteneria e Portit, kur kushtet e motit dhe te detit jane jo te favorshme ose per te tjera arsye te forta.
- c) Operacionet e sondazhit dhe marrja e mostrave te ngarkeses te anijes-cisterne duhet te kryhen ne prezence te nje oficeri te emeruar nga Kapiteni i anijes, i cili do te kete pergjegjesine ne drejtimin e puneve (veprimeve) dhe operacionet do te kryhen nga nje personel i specializuar i punesuar nga Porti, te vrojtuar sipas rregullave te meposhtme:
- Perpara hyrjes ne Port, presioni i Gazit Inert ne cisterne duhet te ulet;
 - Operacionet duhet te kryhen ne fillim tek njera çisterne, por duke mbyllur (e shkeputur nga) te tjerat;
 - Koha gjate se ciles kapaku i çisternes do te jete e hapur gjate kryerjes se operacioneve duhet te ulet ne minimum;
 - Te gjithë elementet e instrumentave dhe te pajisjeve te perbere prej metali qe perdoren per kampionin dhe marrjen e mostrave duhet te jene te lidhura mes tyre dhe trupit te anijes per te garantuar vazhdimesine e rrymes elektrike;
 - Litaret e perdorur per te leshuar (zbritur) instrumentat dhe pajisjet brenda ne cisterna duhet te perbehen nga fibra natyrale;
 - Kampionet (mostrat) e marra duhet te transportohen brenda eneve (konteinereve);
 - Nese anija transporton ose ka transportuar produkte me pike flakerime nen 60°C, gjate operacioneve te sondazhit dhe te marrjes se kampionit me presion gazi te reduktuar, nuk duhet te ndiqet asnje operacion shkarkimi, ballastimi ose afrimi i varkave ose te cdo tipi tjeter anije, ndersa lejohet lidhja ose shkeputja e kraheve te shkarkimit tek tubat e kuvertes;
 - Operacionet e shkarkimit, ballastimit dhe operacionet e bankerimit do te lejohen te fillojne vetem pas normalizimit te presionit te gazit inert e pas kontrollit te funksionimit korrekt te impiantit;

- d) Nëse nuk mund të përmbushen kërkesat e paraqitura në artikullin c), operacionet e shkarkimit duhet të nderpriten menjëherë dhe do të informohen menjëherë Kapiteneria e Portit dhe Porti i Hidrokarbureve "Romano Port" sh.a.
- e) Për ndjekjen e veprimeve që do të kryhen deri në fund të operacioneve të shkarkimit, do të ndiqen të njëjtat metoda dhe do të merren të njëjtat masa;

NENI 13. RREGJISTRUESIT AUTOMATIKE TE MOSTRES, TE PRESIONIT, TE TEMPERATURES, TE PRURJES TE JENE INSTALUAR NE KRAHET E SHKARKIMIT, TUBACIONET, ETJ

- a) Rregjistruesit automatike të presionit, të temperaturës, të prurjes dhe çdo instrument tjetër që do të instalohet në krah të shkarkimit, tubacionet etj., duhet të testohen nën një presion 1,5 herë më të lartë se presioni i punës së tyre të njëjtave tubacioneve, kraheve të shkarkimit, etj.
- b) Kolaudimi (kryerja e testimit) të instrumentave duhet të kryhet vetëm nga inxhinierët profesionistë të autorizuar të certifikuar dhe të autorizuar. Këto teste do të kryhen çdo 2 vjet dhe certifikata e testimit do të ruhet në Kapitenerinë e Portit.
- c) Shoqëritë / firmat që ndjekin procesin e marrjes së kampioneve duhet të përdorin vetëm instrumentat që i janë nënshtruar kolaudimit prandaj, çdo herë duhet të komunikohen matrikullat përpara përdorimit.

NENI 14. KOMPANITE DHE PERSONELI I NGARKUAR PER SONDAZHET DHE MARRJEN E MOSTRAVE TE NGARKESES

Kompanitë që ndjekin marrjen e kampioneve (mostrave) të ngarkesës mbi anijet-cisterne të ankoruara në radë ose të ankoruara në platformën e shkarkimit të Portit, duhet t'i paraqesin Kapitenerisë së Portit një deklaratë të fillimit të operacioneve të shoqëruar me një Certifikatë në përputhje me rregulloren e Portit. Deklarata duhet të shoqërohet me një listë të personelit të ngarkuar për marrjen e kampioneve dhe një deklaratë të shoqërisë bashkëngjitur, që verteton certifikatat e trajnimit të ekipit, sipas se ciles personeli i ngarkuar për kryerjen e procesit të marrjes së kampioneve është trajnuar për lëndet e rrezikshme dhe produktet e djegshme dhe që kanë të paktën 1 vit eksperiencë në këtë fushë.

KREU VI

SHERBIME TE NDRYSHME

NENI 15. OPERACIONET QE PERFSHIJNE RRJEDHJEN E PRODUKTEVE TE NAFTES NE TUBACIONE

Per te gjitha operacionet qe perfshijne rrjedhjen e produkteve te naftes ne tubacionet e Portit te Hidrokarbureve "Romano Port" sh.a., shoqeria duhet te informoje dhe konstatoje cdo demtim, nderprerje, aksident dhe paaftesi ne fund te operacioneve.

NENI 16. RREGULLAT PER RUAJTJEN E AMBIENTIT DETAR NGA NDOTJA

1. Administrata e Portit mer masa te nevojshme per zbatimin e ligjislacionit kombetar ne fuqi dhe atij Nderkombetar ku Republika e Shqipërsie eshte pale, per sa i perket ruajtjes se ambientit detar.

2. Ne Portin e Hidrokarbureve "Romano Port" sh.a. eshte e **NDALUAR**:

- pompimi i ujit te ballastrave dhe te cdo lengu tjetër qe permban mbetje naftë, ne det;
- shkarkimi i cdo produkti hidrokarbur ne det, nga rrjedhjet e tubacioneve ose valvulave;

3. Per cdo derdhje te produktit duhet te sinjalizohet Kapiteneria e Portit e cila menjehere duhet te marre masat e nevojshme.

4. Administrata e Portit te Hidrokarbureve "Romano Port" sh.a. ka detyrim te pastroje ujrat rreth Portit dhe molit qe ka ne koncension sipas rregullave te leshuara nga Kapiteneria e Portit.

5. Administrata e Portit "Romano Port" sh.a. duhet te organizoje sherbimin per parandalimin e ndotjes se portit dhe duhet te nderhyje menjehere nese ka ndotje dhe te perballet me pergjegjesit. Gjithashtu stafi i punonjesve dhe pajisjet qe do te perdoren per parandalimin e ndotjes ne det, duhet te jene te autorizuar sipas rregullave.

6. Personeli i punesuar ne kete operacion duhet te jete i trajnuar. Pajisjet dhe produktet qe perdoren ne rast emergjence duhet te jene te pershtatshme e te mjaftueshme, qe i plotesojne standartet e kerkuara nderkombetare.

NENI 17. BALLASTIMI (EKUILIBRIM ME BALLASTRA)

1. Operacionet e ballastimit duhet te kryhen ne menyre te tille qe te evitohen ose se paku te pakesohen ne maksimum emisionet e avujve te leshuar ne atmosferere, duke marre masat ne vazhdim:

2. Mbushen per ballastim vetem cisternat rezerve per "Ballastim te perkohshem";
3. Kryerja e ballastimit njekohesisht me operacionet e shkarkimit;
4. Në pamundësi të realizimit si në pikat 1 dhe 2 duhet të sinjalizohet Kapiteneria e Portit për të planifikuar një procedure alternative.

NENI 18. MARRJA OSE HEQJA E FURNIZIMEVE DHE PAJISJEVE TË ANIJES

Furnizimi ne bord i materialeve te aparaturave dhe te pjeseve te nderrimit duhet te vendosen në kiç të anijes.

NENI 19. OPERACIONET E FURNIZIMIT TE ANIJES ME LENDE DJEGESE, USHQIME, UJE, ETJ.

1. Operacioni i furnizimit te anijes me lende djegese, ushqime, uje, etj., qe operojne ne port, duhet të kryhen pas komunikimit me Drejtuesin e Forcave të Sigurisë së Portit dhe Kapitenerinë e Portit.

Për këtë do të zbatohet rregullorja për sigurinë e portit.

2. Mjetet e perdorura per furnizimin e anijeve te ankoruara ne port duhet te jene posacerisht per kete sherbim. Gjate gjithe kohes se furnizimit, nje operator do te qendroje ne afersi te procesit, qe ne rast nevojte te beje stakimin sa me shpejt. Ne raste emergjence mjetet e furnizimit duhet te jene gjithmone ne gatishmeri, per tu larguar me shpejtesi.

3. Mjete furnizuese qe ankorohen afer anijeve-cisterne duhet te jene te mbrojtura, per te parandaluar kontaktin mes trupit te anijes dhe, duhet te pajisen me ndarese; mbrojtese-shkendijash te vendosuara tek te gjitha tubat shkarkimit te kaldajes dhe motorrave.

4. Operacioni i furnizimit me karburant duhet te kryhet pa asnje nderprerje, ditën, natën edhe ne dite festash.

5. Operacionet e matjes dhe marrjes se mostres (kampionit) ne cisternat (tankerat) qe mbajne produkte me pike te flakerimes deri ne 60°C, **NUK DO TE LEJOHEN.**

6. Gjate operacioneve te furnizimit duhet te jene gati per perdorim, per cdo nderhyrje, mjetet kundra-zjarrit si ne bord edhe ne Fasilitet.

7. Porti do te rregjistroje oren e fillimit dhe perfundimit te kryerjes se operacioneve te furnizimit, dhe kohen e pezullimit, cilesine dhe sasine e produktit te furnizuar, emrin e furnizuesit dhe mjetit te furnizimit, vonesat, problemet dhe incidentet qe mund te ndodhin gjate furnizimit.

NENI 20. ANIJET DHE BARKAT QE ANKOROHEN PRANE ANIJES-CISTERNE

Anijet dhe barkat qe ankorohen prane anijes-cisterne per te imbarkuar ose zbarkuar; ekuipazhin; furnitoret ose pajisjet per cfaredo lloj motivi dhe arsye, duhet te jene te mbrojtura mjaftueshem tek paraula, per te parandaluar kontaktin me trupin e anijes, dhe duhet te pajisen me ndarese (mbrojtese-shkendijash) ne te gjithë tubat e shkarkimit te kaldajes dhe motorrave. Gjate kohes se shkarkimit **NUK LEJOHEN** anije allaj te afrohen afer anijes qe po shkarkon.

NENI 21. IMPIANTET E GAZIT INERT

- a) Anijet te pajisura me Sistemin e Gazit Inert, edhe nese transportojne produkte hidrokarbure me piken e flakerimit deri ne 60°C (me tanker te mbyllur) dhe tensioni RVP me te ulet se presioni atmosferik duhet ta mbajne cisternen ne kushte te inertizimit.
- b) Sistemi i Gazit Inert [i permendur ne piken a)] duhet te projektohet, ndertohet dhe te operoje sipas rregullave te njohura nderkombetare.
- c) Certifikata qe percakton perputhjen e Sistemit te Gazit Inert sipas rregullave te mesiperme jepet si nje “Certifikate e Sigurise per Pajisjet e Anijes e Ngarkimeve” leshuar nga autoritetet perkatese te shtetit sipas flamurit perkates.
- d) Nder te tjera anija duhet te kete ne zoterim “Manualin Operativ te Sistemit te Gazit Inert”, pergjithesisht te njohura ne nivelet e rajonit. Sistem i Gazit Inert duhet tu permbahet ne menyre strikte rregullave te manualit.

NENI 22. AVARITE E SISTEMIT TE GAZIT INERT

- a) Ne rast se nje avari e vendos Sistemin e Gazit Inert ne kushte qe nuk mund te jete i afte te jape cilesine dhe sasine e kerkuar te Gazit Inert ose ne rast te pamundesise te mbajtjes se cisternave te ngarkeses dhe ne rezervuaret e mbetjeve nen nje presion pozitiv, Kapitene i anijes duhet te marre masat e domosdoshme dhe menjehere, per te ndaluar futjen e ajrit ne cisterne, ne rast te kundert duhet te informoje Kapitenerine e Portit dhe Portin.
- b) Operacionet e shkarkimit te ngarkeses e te ballastimit duhet te pezullohen dhe te mbyllet valvula e nderprerjes se Gazit Inert ne Pontil, dhe valvula e rregullimit te presionit te gazit duhet te lihet hapur per te lejuar shkarkimin (daljen) e gazeve ne hapesire. Asnje lloj objekti (tankeri), pajisje per sondazhin, ose ndonje pajisje tjeter nuk do te nderhyje ne cisterna (tankera).
- c) Duhet te merren masa te menjehershme per riparimin e avarise. Riparimet mbi Sistemin e Gazit Inert ne anijen e ankoruar ne kalaten e Portit, do te kryhen pasi te jete njoftuar Kapiteneria e Portit, vetem ne kushte te tilla si:
 - nese jane siperfaqe te vogla;
 - nese behet fjale per pune “te ftohta”;

- sipas rregullores, maksimumi i kohezgjatjes se punes nuk duhet te zgjase jo me shume se 8 ore;

Kapiteni i anijes per te kryer punimet ne Sistemin e Gazit Inert ne anijen e ancoruar ne kalaten e Portit, duhet t'i paraqese Drejtuesit te portit dhe Kapitenerise, nje kerkese sipas Shtojces 7. Drejtuesi i portit pasi merr mendimin e konsulentit kimik dhe ne konsultimin me Kapitenerine vendos nese do te kryhen apo jo punimet.

- d) Nese do te jete e pamundur te rikthehet funksionimi i Sistemit te Gazit Inert ose nese jane te nevojshme riparimet te cilat nuk mund te kryhen ne vendin e ancorimit, Kapiteneria e Portit do te jape urdherin e nisjes se anijes nga Porti. Anija mund te kthehet ne port vetem pasi ka kryer riparimet e nevojshme te Sistemit te Gazit Inert, dhe nese ka rikthyer ne kushte normale inertet e cisternes te ngarkeses, ne lidhje me cilesine dhe sasine te Gazit inert.
- e) Nese nuk eshte i mundur evitimi i avarise ne Sistemin e Gazit Inert, Kapiteni i anijes do kerkoje vazhdimesine e shkarkimit te ngarkeses duke i paraqitur Kapitenerise se Portit, nje kerkese (Shtojca 8) me specifika, bazuar ne "Manualin Operativ te Sistemit te Gazit Inert", i cili duhet te kryeje operacionin e shkarkimit ne kushte sigurie. Kapiteneria e Portit do te marre parasysh opinionin e nje konsulenti kimik te Portit, ne profilin operativo/tregtar (Shtojca 8). Rregullimi i avarive te Sistemit te Gazit Inert, perjashton mundesine edhe per kryerjen e procesit gjate shkarkimit.
- f) Nese Kapiteni i anijes brenda 1 ore nga pezullimi i operacioneve te shkarkimit nuk kerkon:
 - Autorizimin per rikthimin ne funksion te plote te Sistemit te Gazit Inert;
 - Autorizimin per perfundimin e operacionit te shkarkimit duke adoptuar masa paraprake sigurie;
 - Kapiteneria e Portit nuk leshon autorizimin e kerkeses

Anija – cisterne **duhet te leshoje** vendin e ancorimit dhe te transferohet ne Rade.

NENI 23. FUNKSIONIMI I LABORATORIT TE PORTIT TE LENDEVE DJEGESE

- a) Kontrolli i cilesise te naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre, qe ndodhen ne nje anije cisterne te transportit, behet konform "rregullave teknike" te detyrueshme per zbatim, sipas VKM nr.646, dt. 12.12.2002. Per kryerjen e analizes se kontrollit te cilesise per naften, gazin dhe nenproduktet e tyre, nenshkruset nje proces verbal ndermjet pritesit te mallit qe ka sjelle ngarkesen dhe perfaqesuesit te Departamentit te Labororit te Hidrokarbureve, sipas Shtojces 10. Per sa kohe laboratori i portit te hidrokarbureve nuk eshte gati, analizat do te kryhen ne laboratorin e Institutit Qendror Teknik ose nje laborator tjeter te miratuar.
- b) Departamenti i Labororit te Portit te jep pergjigjen e analizave te kryera ne perputhje me procedurat e teknikes laboratorike, por jo me vone se 3 ore nga ardhja e analizes ne Laborator.

- c) Analize kontrolli per cilesine e naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre ne nje anije, marrin edhe institucione dhe/ose organizma te tjera shteterore te autorizuar ne baze te legjislacionit ne fuqi.
Perfaqesuesit e institucionet dhe/ose organizmat shteterore te autorizuar, ne baze te legjislacionit ne fuqi, perpara marrjes se analizave se kontrollit ne anijen çisterne ku ndodhet produkti i naftes, paraqesin dokumentin perkates ne Autoritetin e sigurise se Portit, si dhe nenshkruajne nje proces verbal sipas formatit te paraqitur, Shtojca 9.
- d) Per rastin kur pritesi i mallit ka kundërshtim per rezultatet e analizave te kryera nga Departamenti i Laboratorit te Portit, mund te kerkoje riberjen e tyre ne Laboratorin e Inspektoriatit Qendror Teknik, Tirane.
- e) Menyra e marrjes se mostres ne anijen çisterne, qe transporton produkte nafte, te behet sipas Standardit Shqiptar ne fuqi “Nafta dhe Produktet e Naftes” – Marrja e Mostres STASH 47 – 86, Grupi A 19”.
- f) Mostra e naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre, per kryerjen e analizave te kontrollit dhe per ruajtjen e saj, merret per çdo lloj produkti, ne çdo anije çisterne qe e ka sjelle ate ne Portin e Hidrokarbureve.
Ne rast se anija ka disa nen-ndarje te çisternes ku jane depozituar produkte te ndryshme, por edhe i njeiti produkt, mostra per kryerjen e analizave merret e veçante per secilen nen-ndarje.
Ne te gjitha rastet se bashku me mostren merret edhe nje kopje e çertifikates se cilesise dhe te origjines se produktit.
- g) Sasia e mostres se nevojshme qe merret ne çdo anije çisterne qe ka nafte, gaz dhe nenprodukte te tyre, per kryerjen e analizave dhe per ruajtjen e saj, te jete:
- **per gazoilin, benzinen dhe vajgurin:**
4,5 litra per departamentin e laboratoreve, nga te cilat 3 litra per analiza ne laborator dhe 1,5 litra per ruajtjen ne Departamentin e Laboratorit te Portit. Pritesit te mallit qe ka produktin i lihet ne ruajtje 1,5 litra.
 - **per gazin e lengezuar te naftes (GLN):**
2 (dy) bombola, ne sasine 3 litra secila, nje per Departamentin e Laboratorit dhe nje per ruajtje nga pritesi i mallit
 - **per naften bruto dhe per te gjitha nenproduktet e tjera, perfshire edhe vajrat dhe alkoolet per prodhimin e hidrokarbureve:**
3 (tre) litra, nga te cilat 1 liter per analize ne laborator, nje liter per ruajtje ne Departamentin e Laboratorit dhe 1 liter per ruajtje nga pritesi i mallit.
- h) Amballazhet per marrjen e mostrave te naftes, gazit dhe nenprodukte te tyre sigurohen nga Departamenti i Laboratorit te Portit te Hidrokarbureve, per produktet e lengshme ato duhet te jene te pastra, te thata dhe nje perdorimshe, ndersa per gazin e lengezuar te naftes te jene bombola. Mostra merret me te njeitin amballazh, hermetizohet, sekretohet me pranine dhe firmosjen e perfaqesuesve te Departamentit te Laboratorit te Portit te Hidrokarbureve dhe te pritesit te mallit qe ka produktin, si dhe pajiset me etiketen perkatese te identifikimit.

- i) Ne rast kontestimi dhe ankese te pritesit te mallit per rezultatet e analizave te mostres se produkteve te naftes, mostrat ne ruajtje ne Departamentin e Labororit te Portit te Hidrokarbureve dhe tek pritesit e mallit, do te likujdohen vetem pas marrjes se nje vendimi perfundimtar per ankesen.
- j) Mbas perfundimit te afatit te ruajtjes se mostres te produkteve te naftes, i cili ne çdo rast nuk mund te jete me shume se tre muaj, mostrat ne ruajtje ne Departamentin e Labororit te Portit te Hidrokarbureve dhe tek pritesi i mallit do te perdoren sipas rregullave financiare ne fuqi, duke i arketuar te ardhurat ne emer te Kapitenerise se Portit te Hidrokarbureve.
